

VENDIM
Nr. 465, datë 3.6.2015

**PËR PAGESAT E NDIHMËS EKONOMIKE DHE ATO PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA (PAK) NË KOMUNËN SHALË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27, pika 5, e 28, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 4, dhe të pikave 3, shkronja “c”, e 4 të nenit 11, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pagesat e ndihmës ekonomike dhe ato për personat me aftësi të kufizuara, në komunën Shalë, të qarkut të Shkodrës, të bëhen nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, në Shkodër, sipas listës së paraqitur nga administratori shoqëror i kësaj komune.
 2. Dega e Thesarit Shkodër të kryejë pagesat për përfituesit brenda 7 (shtatë) ditëve kalenda-rike, sipas listës së dërguar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, në Shkodër.
 3. Pagesat sipas pikës 1, të këtij vendimi, të mbulohen nga buxheti i vitit 2015 i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
 4. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, në Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet deri në shtator 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama